



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:031985
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05600157

C.nr.301/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.C. nga fshati R., Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Eleonora Nrecaj -Berisha, avokat nga Prishtina, sipas autorizimit, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 950 euro, në seancën e datës 03.04.2024 mori, ndërsa me datën 17.04.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit H.C. nga fshati R., Komuna Pejë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS, me seli në Prishtinë, e parashtruar me datë 02.03.2020, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 950 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi H.C. nga fshati R., Komuna Pejë, përmes të autorizuarit të tij, me datë 02.03.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 950 euro.

Gjykata, me datën 03.04.2024 ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra palë në procedurë, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk kanë prezantuar dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit”*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.301/20, me datë 03.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.